



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1745 prot.

Pukë, më 07.10. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 9 datë 07.10.2025

PËR

DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I BASHKISË PUKË

Z. BEQIR ARIFAJ

(Pas vdekjes)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë _____.10.2025;

Vendosi:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. BEQIR ARIFAJ

(Pas vdekjes)

Me motivacionin:

“Në vlerësim të kontributit të tij të shquar si mësues e drejtues shkolle, funksionar në disa nivele të pushtetit vendor dhe Kryetar i Bashkisë Pukë (2011–2015), si dhe për rolin e tij si gazetar, publicist dhe zë i angazhuar në jetën publike të qytetit, si dhe në nderim të figurës dhe trashëgimisë së tij qytetare e profesionale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqiten projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 174 prot.

Pukë, më 07.10. 2025

RELACION
Mbi
PROJEKT VENDIMIN
Nr. 09, datë 07.10. 2025

PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' I BASHKISË PUKË

Z. BEQIR ARIFAJ

(Pas vdekjes)

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa "m"; ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënie e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, sjellim për miratim këtë projektvendim, i cili është vijimësi e vlerësimit të disa figurave që kanë lënë gjurmë me rolin dhe kontributin e tyre, duke i shërbyer atdheut dhe kombit në rrugën e tij drejt zhvillimit dhe prosperitetit.

Emri i z.Beqir Arifaj, i propozuar për dhënie e titullit "Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) i Bashkisë Pukë, pasi ka kaluar Komisionin Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, paraqitet sot për këtë vlerësim, duke çmuar rolin e tij si mësues dhe drejtues shkolle në edukimin e brezave dhe formimin e vlerave njerëzore, si dhe për spikatjen e tij në postet dhe detyrat e ndryshme të rëndësishme në strukturat e pushtetit vendor, duke kontribuar për ndërtimin dhe forcimin e institucioneve vendore.

Nisur nga rol, i faktuar përmes veprave konkrete, ju ftoj t'a votoni këtë projekt-vendim!

Bashkëlidhur:

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 09, datë 07.10.2025

PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' I BASHKISË PUKË Z. BEQIR ARIFAJ,
(PAS VDEKJES)

2. Dokumentacioni njohës mbi jetën dhe veprën e tij.
3. Miratimi i Komisionit Këshillimor.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni

JETËSHKRIM

Beqir Man Arifaj

Beqir Arifaj lindi më 24 shtator 1954 në fshatin Iballë, Pukë.

Në vitin 1973 përfundoi studimet në Shkollën Pedagogjike “Shejnaze Juka” në Shkodër dhe në vitin 1987 u diplomua në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, në degën Gjuhë dhe Letërsi. Gjatë karrierës së tij arsimore ka përmbushur të gjitha fazat e kualifikimit si mësues dhe drejtues shkollash, deri në vitin 1996.

Z. Arifaj ka qenë i specializuar në fushën e drejtimit dhe menaxhimit të administratës publike. Gjithashtu, ka përfunduar nivelet e parë dhe të dytë të njohjes së gjuhës gjermane.

Përvoja profesionale:

- 1973–1991: Mësues në disa shkolla 8-vjeçare dhe të mesme në rrethin e Pukës.
- 1991–1995: Drejtor i shkollës 8-vjeçare në Fushë-Arrëz.
- 1995–1996: Inspektor në Drejtorinë Arsimore të Pukës.
- 1996–1997: Drejtor i shkollës së mesme “Sabah Sinani”, Pukë.
- 1997–2000: Zëvendësdrejtor në të njëjtën shkollë.
- 2001–2010: Sekretar i Këshillit Bashkiak, Pukë.
- 2010–2011: Nënprefekt i rrethit Pukë, pranë Prefekturës Shkodër.
- 2011–2015: Kryetar i Bashkisë Pukë.
- 2017–2019: Punonjës në Bashkinë Lezhë, pranë sektorit të Trashëgimisë Kulturore.

Më 30 shtator 2019, Beqir Arifaj doli në pension. Në vitin 2020 botoi monografinë “Man Avdi Arifaj”.

Më 27 nëntor 2020, u nda nga jeta, duke lënë pas një trashëgimi të çmuar qytetare dhe profesionale si dhe një kujtim të paharruar në zemrat e familjarëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij.